

REPUBLICA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E DREJTËSISË/MINISTARSTVO PRAVDE
MINISTRY OF JUSTICE

Nr.Br.No: 06-429

Data/Datum/Date: 22/04/2021

Shtojca/Dodaci/Annex: 1B-P.

PRISHTINË/A



REPUBLICA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E DREJTËSISË/ MINISTARSTVO PRAVDE/ MINISTRY OF JUSTICE

KONTRATË PUBLIKE KORNIZË
SHËRBIME

TITULLI:

**Shërbimet e transportit të automjeteve, pajisjeve, mallrave dhe
makinerisë së konfiskuar**

Nr. i Prokurimit: 21500-21-391-2-2-1

Nr. i brendshëm: 2150-20-002-221

Nr. i kontratës 04/V/2021

Prishtinë, 22 prill, 2021

KONTRATA PUBLIKE KORNIZË
21500-21-391-2-2-1/C22

MINISTRIA E DREJTESISË, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë;
dhe

Operatori ekonomik "Dreni - A " SH.P.K., Rr. Llapi p. N, Komuna Fushë Kosovë, (në vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për Shërbimet në vijim:

Titulli i kontratës: "Shërbimet e transportit të automjeteve, pajisjeve, mallrave dhe makinerisë së konfiskuar", me numër identifikues: 21500-21-391-2-2-1 si dhe numër të brendshëm

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është qe të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve në vijim:

Shërbimet e transportit të automjeteve, pajisjeve, mallrave dhe makinerisë së konfiskuar në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës varësisht prej kërkesave të prokurorisë dhe gjykatave.

Autoriteti kontraktues kryen blerje vetëm në emër të vet.

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek Ofruesi i shërbimeve, duke specifikuar listën e shërbimeve qe duhet te performohen me sasi të tyre përkatëse.

1.3 Sasi të vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) i/ të detyruar të përdorë/in këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë shërbimet e përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me 22.04.2021 dhe përfundon në datën **21.04.2024**

Neni 2 Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për kryerje të shërbimeve do të jetë (1 ditë) nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë në bazë së kërkesës nga Autoriteti Kontraktues

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimet për njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Shërbimeve në shtojcën e kësaj kontrate.

Vlera e kontratës sipas pozicioneve të paraqitura është totali i vlerës së peshuar 2,20 Euro për njësi. Vlera e kontratës është indikative dhe në bazë të vlerës së parashikuar është 50,420.00Euro.

Devimi i lejuar nga vlera totale indikative është [+ 30 % apo - 30%].

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njërive do të jenë fikse dhe nuk do të nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë.

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 4 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;
- (g) *Sigurimi i ekzekutimit*].

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me



shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shënohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Sadri Emërllahu
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	22.04.2021
Vula:	

Për Ofruesin e Shërbimeve

Emri:	HASDAR MORINA
Pozita:	MANAGER
Nënshkrimi:	
Data:	22.04.2021
Vula:	